Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 14 mars 2013

Lënda nr. 331/09

Nebojsha MILADINOVIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 14 mars 2013,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua dhe u regjistrua më 4 dhjetor 2009.

2. Më 4 prill 2012, Paneli kërkoi nga ankuesi të paraqesë informacione shtesë. Më 12 prill 2012, Paneli morri informacione nga ankuesi. Më 3 tetor 2012, Paneli kërkoi nga ankuesi të paraqesë informacione plotësuese; mirëpo, lidhur me këtë nuk është marrë asnjë përgjigje.

3. Më 22 shtator 2011, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. Më 28 tetor 2011, PSSP-ja ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

4. Ankuesi është ish banor i Kosovës i cili aktualisht jeton në Serbi. Ai pretendon se është pronar aktual i disa parcelave kadastrale që më parë kanë qenë në pronësi të babait të tij, duke përfshirë ndërtesa banimi, objekte bujqësore, ndërtesa përcjellëse dhe pemishte në fshatin Miraqë, komuna e Vushtrrisë, dhe në qytetin e Vushtrrisë. Në mënyrë më specifike, prona në fshatin Miraqë përfshinte një shtëpizë, dhe prona në Vushtrri përfshinte një shtëpi.

5. Ankuesi thekson se babai i tij kishte jetuar në pronat e lartcekura deri në vitin 1999 kur ai ishte detyruar të largohet për shkaqe sigurie. Ankuesi thekson se ai ishte informuar se shtëpiza në fshatin Miraqë ishte dëmtuar në vitin 2002, kurse shtëpia në Vushtrri ishte uzurpuar. Më 28 gusht 2006, pas vdekjes së të atit, ankuesi i trashëgoi të drejtat për pronat e lartcekura.

A. Procedura aktuale pranë gjykatës komunale në Vushtrri

6. Më 25 maj 2005, babai i ankuesit parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Vushtrri kundër komunës së Vushtrrisë, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ-ve), UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 152,800 euro kompensim për këtë dëm. Ankuesi i trashëgoi të drejtat pronësore.

7. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin, dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

8. Në vitin 2004 u paraqitën rreth 17,000 kërkesa për kompensim pranë gjykatave të Kosovës, shumica prej tyre nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të luftës i kishin braktisur shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të përmbushjes së afatit të parashkruar pesëvjeçar për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i parashtruan kërkesat e tyre rreth kohës së njëjtë në vitin 2004. Kërkesat u ishin drejtuar UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (më tutje: HRAP), *Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit i bazuan kërkesat e tyre, shih mendimin e njëjtë § 5).

9. Lidhur me këto raste, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në atë shkresë, Drejtori i DD theksoi se ishin parashtruar "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemit që do të paraqiste një fluks kaq i madh i kërkesave për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohet për shqyrtim derisa bashkërisht të vendoset se si më së miri të procedohen këto raste" (për tekstin e plotë të shkresës, shih mendimin *Milogorić dhe të Tjerët*, të cituar në § 7 lart, në § 6).

10. Më 15 nëntor 2005, DD ftoi gjykatat të fillojnë procedimin e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit 2000, duke konsideruar se "pengesat për procedimin efikas të këtyre rasteve" më nuk ekzistonin. Kërkesat që kishin të bënin me ngjarjet para tetorit 2000 nuk ndikoheshin nga kjo shkresë.

11. Më 28 shtator 2008, Drejtori i DD informoi gjykatat që rastet të cilat nuk ishin caktuar për shqyrtim në pajtim me kërkesën e 26 gushtit 2004, të procedohen tani.

12. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

B. Procedura pranë Drejtorisë për Çështje Banesor Pronësore dhe Agjencisë Kosovare të Pronës

13. Më 26 mars 2002, babai i ankuesit parashtroi kërkesë në Drejtorinë për Çështje Banesore Pronësore (HPD) për riposedimin e shtëpisë në Vushtrri. Më 18 dhjetor 2002, babai i ankuesit parashtroi kërkesë në Drejtorinë për Çështje Banesore Pronësore (HPD) për riposedim të pronës në fshatin Miraqë.

14. Më 11 prill 2003, KAÇBP nxori vendim me të cilin pronën ia dha babait të ankuesit në Vushtrri. Prona ishte vënë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), pasardhësja e HPD-së më 7 mars 2006. Mirëpo, AKP-ja kërkoi nga ankuesi të tregojë dëshmi të trashëgimisë para se ta lejojë atë të përfshihet në skemën vullnetare të qiradhënies. Në janar të vitit 2012, ankuesi ia siguroi informacionet e tilla AKP-së. Mirëpo, AKP-ja nuk kishte mundur të jep me qira pronën e ankuesit dhe kështu nuk ishin mbledhur të ardhura nga qiraja për të. Në ndërkohë, ankuesi u ankua në AKP. AKP-ja e informoi ankuesin se nuk ishte përgjegjëse për dëmet e mëpastajme që ju kishin shkaktuar shtëpisë dhe se ankuesi duhet ta drejtojë ankesën e tij në gjykatën përkatëse. Nuk ka informacione se janë ndërmarrë veprime të tilla.

15. Më 27 gusht 2004, Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore (KAÇBP) i HPD-së nxori vendim në të cilin thuhej se prona e babait të tij në Miraqë ishte shkatërruar por se babai i tij ishte pronar i ngastrës së zbrazët. Më 9 korrik 2007, ankuesi paraqiti kërkesë në AKP për të korrigjuar gabimet në vendimin e tyre lidhur me klasifikimin e pronës. Më 13 qershor 2008, AKP-ja ju përgjigj ankuesit dhe ju referua një shkrese të cilën qëllimisht ia kishte dërguar qoftë atij apo të atit më 29 mars 2005. Ankuesi argumenton se ai asnjëherë nuk ka marrë një shkresë të tillë.

16. Më 5 shkurt, 27 shkurt dhe 9 korrik 2007, ankuesi i paraqiti edhe 26 kërkesa AKP-së duke kërkuar riposedimin e pronave të tij që ndodheshin në fshatin Miraqë. Sipas ankuesit, këto kërkesa ishin miratuar nga AKP-ja në vitin 2008, por më vonë ishin anuluar për shkak të njoftimeve të pasakta. Nga janari 2012, AKP-ja kishte miratuar 11 nga këto kërkesa dhe ato prona i kishte vënë nën administrimin e saj, me kërkesën e ankuesit. AKP-

ja e informoi Panelin se 15 kërkesat tjera akoma ishin në faza të ndryshme të procedimit të tyre.

III. ANKESA

17. Ankuesi në esencë pohon se gjykata komunale e Vushtrrisë ka pezulluar procedurën lidhur me ankesën e tij për dëmshpërblim për pronën e shkatërruar, dhe se si pasojë e kësaj këto procedura nuk janë përfunduar brenda një periudhe kohore të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ai pretendon se për arsyen e njëjtë është shkelur edhe e drejta e tij për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ.

18. Ankuesi gjithashtu ankohet se me shkatërrimin e pronës së tij dhe me refuzimin e gjykatës komunale në Vushtrri për të vendosur mbi ankesën e tij për dëmshpërblim, është shkelur e drejta e tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ).

19. Përveç kësaj, ankuesi ankohet për kohëzgjatjen e procedurës lidhur me kërkesën e tij pronësore pranë HPD-së dhe AKP-së dhe për mos-kompensim nga AKP-ja për dëmet e shkaktuara pronës së tij. Në këtë aspekt ai mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për të marrë vendim nga gjykata brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ dhe në shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

IV. ZBATIMI I RREGULLËS 29*BIS* TË RREGULLORES SË PUNËS SË PANELIT

20. Paneli thekson se pjesa e ankesës që ka të bëjë me pezullimin e procedurës nga gjykata komunale e Vushtrrisë lidhur me kërkesën e tij për kompensim ngrit çështje të cilat në esencë janë të njëjta sikurse ato që janë ngritur, në mesin e tjerave në rastet me nr. 38/08, *Milogoriç*, 58/08, *Zhivaljeviç*, 61/08, *Gojkoviç*, 63/08, *Çukiç*, dhe 69/08, *Bogiçeviç*, të cilët tanimë janë shqyrtuar nga Paneli. Për më tepër, nga dosjet shihet se nuk janë paraqitur çështje të reja të pranueshmërisë lidhur me rastet aktuale. Prandaj, në pajtim me Rregullën 29*bis* të Rregullores së punës së Panelit, Paneli konstaton se nuk është e nevojshme që kjo pjesë e kësaj ankese t'i komunikohet UNMIK-ut dhe se mund të shqyrtojë pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesës pa e bërë këtë.

IV. LIGJI

21. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

Procedura gjyqësore pranë gjykatës komunale në Vushtrri

Pohimi për shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ

22. Paneli konsideron se, përderisa ankuesi thirret në shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ, ai në fakt ngrit dy ankesa (shih qasjen e miratuar, në mes tjerash, në PKDNJ, *Milogoriç*, nr. 38/08, vendim i 22 majit 2009; krahaso Gjykata Evropiane e të Drejtave të

Njeriut (GJEDNJ), *Açimoviç kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendim i 30 majit 2000; GJEDNJ, *Kutiç kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendim i 11 korrikut 2000). Në njërën anë, ai ankohet për faktin se për shkak të pezullimit të procedurës në gjykatën komunale të Vushtrrisë, ai nuk ka pasur mundësi të merr vendim për kërkesat e tij për kompensim për pronën e dëmtuar. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngrit çështjen e të drejtës së tij për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ dhe të drejtën e tij për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ. Në anën tjetër, ai ankohet për kohëzgjatjen e procedurës pranë gjykatave kompetente, nga fakti se procedura është iniciuar në vitin 2005 dhe se kjo kërkesë nuk është shqyrtuar që atëherë. Kjo ankesë mund të ngrit çështjen e të drejtës së tij në vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

23. Paneli konsideron se ankesa lidhur me procedurën gjyqësore pranë gjykatës komunale në Vushtrri lidhur me nenet 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ ngrit çështje serioze faktike dhe juridike, vendosja e të cilave duhet të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo ankesë nuk është e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih, në mes tjerash, PJDNJ, *Milogoriç*, cituar në § 20 lart, në § 18).

24. Arsye tjetër për shpalljen e kësaj pjese të ankesës të papranueshme nuk është konstatuar.

Pohimi për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ

25. Ankuesi ankohet për shkelje të së drejtës së tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1). Ai përgjithësisht ankohet për faktin se prona e tij është dëmtuar ose shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999, dhe ankohet për dështimin e gjykatës komunale të Vushtrrisë për të vendosur për kërkesat e tij për kompensim.

26. Paneli përkujton se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat që kanë të bëjnë me pohimin e shkeljes së të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që janë paraqitur para kësaj date, kur faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Dëmtimi dhe shkatërrimi i pasurisë janë akte të atypëratyshme, që nuk paraqesin shkelje të vazhdueshme (shih PKDNJ, *Lajoviç*, nr. 09/08, vendim i 16 korrikut 2008, § 7). Si rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor *ratione temporis* të Panelit.

27. Sa i përket ankesës se, për shkak të pezullimit të procedurës të iniciuar nga ankuesit, ata deri tani nuk kanë mundur të marrin kompensim për dëmin, Paneli thekson se, përderisa procedurës gjyqësore i referohemi nga pikëpamja e së drejtës në pronë, këto procedura nuk mund të ndahen nga aktet në të cilat bazohen kërkesat pranë gjykatave. Ose, për ta thënë më konkretisht, siç ka bërë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut lidhur me juridiksionin e saj sipas KEDNJ:

> "… Juridiksioni kohor i gjykatës vendoset në relacion me faktet që janë bazë për ndërhyrjen e pohuar. Dështimi i mëvonshëm i mjeteve që kanë synuar kompensimin e kësaj ndërhyrjeje nuk mund ta vë këtë në kuadër të juridiksionit kohor të gjykatës" (GJEDNJ (Dhoma e Lartë), *Bleçiç kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, aktgjykim i 8 marsit 2006, § 77, KEDNJ, 2006-III).

28. Për rrjedhojë kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit *ratione temporis* (shih, në mes tjerash, PKDNJ, *Gojkoviç*, nr. 63/08, vendim i 4 qershorit 2009, §§ 24-25).

Procedura pranë Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore dhe Agjencisë Kosovare të Pronës

Drejtoria për ëështje banesore pronësore

29. Ankuesi gjithashtu ankohet se HPD-ja dhe AKP-ja ia kanë mohuar atij marrjen e vendimit brenda një kohe të arsyeshme, dhe e kanë vonuar atë në realizimin e të drejtave të tij pronësore. Sa i përket HPD-së, babai i ankuesit i paraqiti kërkesat në HPD më 26 mars 2002 dhe 18 dhjetor 2002 dhe mori përgjigje më 27 gusht 2004 përkatësisht më 11 prill 2003, që babait të ankuesit i dha të drejta poseduese për të dyja pronat në Vushtrri (shih § 14 lart) dhe në fshatin Miraqë (shih § 15 lart).

30. Sa i përket procedurës që ndodhi para 23 prillit 2005, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)*.

31. Për veprimet e mëpastajme që kanë ndodhur pas fillimit të juridiksionit të Panelit më 23 prill 2005 lidhur me pronën në Vushtrri, Paneli thekson se ankuesi nuk ja ka treguar dëshminë e kërkuar të trashëgimisë AKP-së për t'u përfshirë në skemën vullnetare të qiradhënies deri në janar të vitit 2012. Për më tepër, AKP-ja nuk kishte mundësi të japë me qira pronën e ankuesit dhe kështu nuk ishin grumbulluar para nga qiraja për të. Prandaj, Paneli hedh poshtë këtë pjesë të ankesës si të pabazuar në shikim të parë.

Agjencia Kosovare e Pronës

32. Sa i përket AKP-së, ankuesi parashtroi 26 kërkesa në AKP më 5 shkurt 2007, 27 shkurt 2007 dhe 9 korrik 2007, dhe lidhur me 15 kërkesa ai pret të marrë vendim gjashtë vite më vonë.

33. Paneli thekson se lidhur me kontrollin administrativ të UNMIK-ut mbi AKP-në, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së në raportin e tij drejtuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, të datës 17 mars 2009, thekson se autoriteti i UNMIK-ut mbi AKP-në nuk u vazhdua pas 31 dhjetorit 2008, kur kontrollin e plotë operacional mbi AKP-në e morën autoritetet e Kosovës dhe një drejtor ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian. Që andej e tutje, AKP-ja punoi në pajtim me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës (shih PKDNJ, *Kushiç*, nr. 08/07, mendimi 15 majit 2010, § 51; PKDNJ, *Felegi*, nr. 32/08, vendim i 20 janarit 2012, § 43; PKDNJ, *B.D*, nr. 129/09, vendim i 6 dhjetorit 2012).

34. Për rrjedhojë, ashtu siç ka gjykuar tanimë Paneli në rastin *Kushiç* (cituar në § 33 lart, në § 52) dhe në *Felegi* (cituar në § 33 lart, në § 44), se nga 31 dhjetori 2008, UNMIK-u nuk mund të mbahet më përgjegjës për veprimet apo mosveprimet me të cilat ngarkohet AKP-ja.

35. Nga kohëzgjatja e përgjithshme e procesit të AKP-së për më shumë se gjashtë vite, ndërmjet shkurtit të vitit 2007 dhe dhjetorit 2008 parqet një periudhë prej përafërsisht një vit e dhjetë muaj që janë në kompetencë të Panelit për shqyrtim.

36. Duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave të paraqitura pranë AKP-së (42,399 kërkesa, nga të cilat 36,017 janë vendosur nga 6 marsi 2013)[1], Paneli nuk konsideron se gjatë asaj periudhe ka pasur vonesë me kohëzgjatje të paarsyeshme. Në fakt, vendimet për këto kërkesa ishin marrë në ndërkohë nga AKP-ja, përkundër faktit se disa ishin regjistruar gabimisht dhe nuk ishin ndryshuar (shih § 15 lart). Prandaj, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës, lidhur me periudhën në fjalë, është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

37. Sa i përket periudhës pas 31 dhjetorit 2008, ankesa është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit (shih § 34 lart).

PËR KËTO ASRYE,

Paneli unanimisht,

- E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN QË KA TË BËJË ME TË DREJTËN E QASJES NË GJYKATË DHE TË DREJTËN PËR MJET TË EFEKTSHËM (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT) DHE TË DREJTËN PËR TË MARRË VENDIM GJYQËSOR BRENDA NJË KOHE TË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT) LIDHUR ME ANKESËN E PARASHTRUAR NË GJYKATËN KOMUNALE NË VUSHTRRI;

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar

[1] Informacione të marra me rastin e qasjes në uebsajtin zyrtar të AKP-së më 6 mars 2013: http://www.kpaonline.org/ClaimsTotalDecided_caseload.asp